



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 1599 / Prot.

Tiranë, më 9 . 3 . 2022

URDHËR

Nr. 118 ; datë 9 / 3 / 2022

PËR

**THIRRJEN PËR PROJEKT PROPOZIME NË FUSHËN E SPORTIT,
PËRCAKTIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES, MËNYRËS SË
VLERËSIMIT DHE AFATEVE TË DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT
APLIKUES PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Ligjit Nr. 79/2017 "Për sportin" të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes për projekt propozime në fushën e sportit, përcaktimit të procedurave të përzgjedhjes, mënyrës së vlerësimit dhe afateve të dorëzimit të dokumentacionit aplikues për vitin 2022.
2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet në përputhje me treguesit e përcaktuar në shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit aplikues për projekt propozimet, do të jetë deri më datë 19.03.2022.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

